

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Xhezair ZAGANJORI	- Kryesues
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

Në datën 14.09.2016 mori në shqyrtim në Dhomën e Këshillimit çështjen administrative nr. 31003-00226-00-2015 akti që iu përket palëve:

PADITËS:	Pranvera Progonati
I PADITUR:	Shërbimi Social Shtetëror
OBJEKTI:	<i>Detyrimi i palës së paditur për të më kthyer në vendin e punës, të më dëmshpërblejë me një vit pagë për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës, tre paga rrjedhojë të mosrespektimit të afatit të njoftimit, dy paga mujore si rrjedhojë e mosrespektimit të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe trembëdhjetë paga shpërblim për vjetërsinë në punë.</i>
BAZA LIGJORE:	<i>Nenet 140, 141, 143, 144, 145, 146 dhe 155 të Kodit Punës, si dhe nenin 31 të K.Pr.Civile.</i>

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4015, datë 15.04.2013 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesës nr. regj. 9938 them. që i përket paditëses Pranvera Progonati. Rrëzimin e kërkesës së detyrimit të palës së paditur për të kthyer paditësen Pranvera Progonati në vendin e mëparshëm të punës. Detyrimin e të paditurit Shërbimi Social Shtetëror të dëmshpërblejë paditësen Pranvera Progonati me 2 paga mujore, për mosrespektim të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit Shërbimi Social Shtetëror të dëmshpërblejë paditësen Pranvera Progonati me 1 vit pagë për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme. Detyrimin e të paditurit Shërbimi Social Shtetëror të dëmshpërblejë paditësen Pranvera Progonati në masën e 2 pagave e gjysëm për vjetërsinë në punë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1276, datë 08.04.2014 ka vendosur:

Moskompetencën e shqyrtimit të çështjes, dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3728, datë 09.10.2014 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit të paraqitur kundër vendimit nr. 4015, datë 15.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur Shërbimi Social Shtetëror, i cili kërkon:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63/c të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”;

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 3728, datë 09.10.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

U shpall në Tiranë, me datë 14.09.2016

Nr. 31003-00226-00-2015 Regj.Themeltar

Dixhitalizuar dhe Perpunuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org